



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës Veriore
Opština Severna Mitrovica – Municipality of Mitrovica North



Në përputhje me nenin 95, 96 dhe 97 të Ligjit nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, nenin 5 dhe 6 të Rregullores (QRK) nr. 27/2024 për Procedurat Konkurrimit për Nëpunësit Teknik dhe Mbështetës, komuna e Mitrovicës Veriore, shpallë:

K O N K U R S

- **Pozita:** Punëtor Sigurimi (1 pozitë)
- **Drejtoria:** Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
- **Klasa/Koeficienti** GJ51/ 3.76
- **Orari i punës:** 40 orë pune në javë
- **Kohëzgjatja:** Në kohë të pacaktuar (puna provuese 6 muaj)
- **Data e njoftimit:** 18.08.2025
- **Afati për aplikim:** Prej datës 19.08.2025 deri më 02.09.2025

Detyrat dhe përgjegjësitë e punës:

- Siguron objektin dhe pasurinë e objektit në përgjithësi në aspektin e sigurisë fizike;
- Gjatë pranimit-dorëzimit të detyrës në libër të veçantë mbanë evidencë mbi vërejtjet që ka gjatë orarit të tij të punës;
- Nuk e lejon hyrjen dhe prezencën e njerëzve të pa autorizuar gjatë ditës dhe natës në objekt;
- Në rast të ndonjë parregullsie gjatë procesit të punës mund të kërkojë ndihmë nga policia nëse është i penguar në kryerjen e detyrës;
- Është përgjegjës për krejt atë çka humb në objektin gjatë ndërrimit të tij;
- Pas përfundimit të orarit të rregullt të punës, bën inspektimin e objektit për të verifikuar a është gjithçka në rregull;
- Duhet të sigurojë, kontrollojë të zyrat apo depot a janë të mbyllura dyert e tyre kur e pranon detyrën;
- Pas çdo ndërrimi duhet të raportojë te mbikëqyrësi;
- Përkujdeset për mirëmbajtjen e pajisjeve kundër zjarrit, dhe njofton mbikëqyrësin për çdo ndryshim në objekt;
- Kujdeset gjatë orarit të punës për sistemin e ngrohjes, të ujit dhe të rrymës;
- Kryen edhe detyra tjera në përputhje me legjislacionin në fuqi të cilat mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi.

1. Kriteret e përgjithshme për pranimit:

- të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi;
- të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- të mos jetë e/i dënuar për kryerjen veprës penale me dashje;
- të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik;
- të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës;
- të kalojë me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në Ligjit nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik.

2. Kërkesat e përgjithshme formale:

- Arsimimi i kërkuar: Shkolla e mesme;
- Përvoja e punës: preferohet përvojë pune relevante një (1) vjeçare

3. Kërkesat e përgjithshme të nevojshme (Njohuri, Aftësi dhe Cilësi):

- Aftësi për zbatimin e procedurave dhe udhëzimeve administrative për kryerje të detyrave të punës;
- Shkathësi komunikimi dhe organizimi të punës.

4. Mënyra e aplikimit:

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Qendrën për Shërbim me Qytetarë, komuna e Mitrovicës Veriore.

5. Dokumentacioni që duhet të dorëzohet për aplikim:

- Kërkesa për punësim (aplikacioni) - i plotësuar;
- Kopjet e dokumentit personal (letërnjoftim ose pasaportë);
- Kopjet e diplomës së shkollës së mesme (diplomat e marra jashtë Kosovës duhet të jenë të nostrifikuara nga Ministria e Arsimit);
- Kopjet e dëshmisë së punësimit (përvojës së punës);
- Certifikata nga gjykata kompetente që dëshmon se nuk jeni i dënuar me aktgjykim të formës së prerë (jo më e vjetër se 6 muaj);
- Certifikata shëndetësore që dëshmon se nuk ka probleme shëndetësore për të kryer detyrat e punës (pas përzgjedhjes nga komisioni).

6. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve:

- Vlerësimi i jetëshkrimit (CV) - deri në 30 pikë
- Intervista me gojë - deri në 70 pikë

7. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët:

Kandidatët do të njoftohen përmes emailit të shënuar në aplikacion, ueb faqes së komunës <https://mitroviceeveriut.rks-gov.net/> dhe portalit për rekrutim elektronik <https://konkursi.rks-gov.net/>

Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre, personat me aftësi të kufizuar dhe gjinia me pak e përfaqësuar kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional, siç specifikohet në Ligjin për Zyratë Publike.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë dhe aplikacionet e mangëta nuk pranohen.